



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR

Nr. 43386 Prot

Shkodër, më 04.06.2026

URDHËR  
Nr. 683 Datë 04/06/2026

PËR NGRITJEN E NJËSISË PËRGJEGJËSE TË SINJALIZIMIT NË BASHKINË  
SHKODËR

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ të ndryshuar ; Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë “në nenin 14 të Ligjit nr.96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” në VKM nr.395 datë 28.05.2026 ”Për marrëdhëniet e punës ,strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësive përgjegjëse të sinjalizimit në autoritetet publike ;

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e Urdhërit nr.840 datë 30.11.2016 “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Bashkinë Shkodër”
2. Ngritjen e Njesisë Përgjegjëse të përhershme për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve të përbërë si më poshtë:
  - **Ardiana Ndoci** Përgjegjëse Njësia e Auditimit të Brendshëm
  - **Blerina Bushati** Specialiste Njësia e Auditimit të Brendshëm
3. Njësia përgjegjëse ndjek në vazhdimësi sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në veprimtarinë e saj si dhe mban kontakte të vazhdueshme me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit ,ILDKPKI.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike ,e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij urdhëri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI  
ZV.KRYETARI  
Alban Preka

